



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORT VJETOR

2019



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Shoqata Shqiptare e Bankave

Selia kryesore: Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower 9/3, Tiranë

Regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e Gjykatës nr.1153, datë 14 prill 1999

NIPT: K51626015F

Prepared by: **AAB Secretariat**
Design & Layout: **FCB AFIRMA**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Mesazh nga Kryetari	4
2. Struktura Organizative	6
3. Asambleja e Anëtarëve dhe Bankat Anëtare	9
4. Përmbledhje e veprimtarive të AAB-së në vitin 2019	10
5. 20 vjet AAB	11
6. Fakte dhe shifra për 2019 - Sektori bankar në Shqipëri	14
7. Shtyllat kryesore të AAB-së	18
a) Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe bashkëpunimi me autoritetet	18
b) Transformimi i sektorit bankar	21
c) Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve të bankës	27
d) Edukimi financiar	33
e) Komunikimet, marrëdhëniet me publikun dhe mbrojtja ligjore	38
8. Komitetet Teknike - Çështjet kryesore dhe arritjet	43
9. Takime të tjera	45
10. Shifra rreth Bankave Anëtare	49
11. Pasqyra Financiare	52

MESAZHI I KRYETARIT

I nderuar Lexues,

Në duart tuaja publikimi më i fundit i Shoqatës Shqiptare të Bankave: Raporti Vjetor 2019. Përveç se një detyrim tashmë rregullativ për organizatat jo-fitimprurëse të publikojnë raportin e performancës, ky raport është një kërkesë standarde e AAB-së për të komunikuar me publikun dhe të interesuarit mbi veprimtarinë e Shoqatës sonë. Transparent, të hapur, me profesionalizëm!

- » Viti 2019 ishte viti i 20 vjetorit të krijimit të AAB-së. Si i tillë, ai nga fillimi deri në fund u shoqërua me logon e 20-vjetorit të krijimit. Festimi i 20-vjetorit u pasua nga organizimi i një konference mbi zhvillimin e qëndrueshëm duke e bërë festën edhe më të plotësuar dhe të paharrueshme!
- » AAB-ja tregoi një solidarizim të plotë me dy fatkeqësitë e shkaktuara nga tërmeti në fund të muajit maj ne Prefekturën e Korçës dhe ai i 26 nëntorit në Durrës me 51 jetë të humbura. Kontributi i AAB-së ishte përkatësisht 10 milionë lekë dhe 200 mijë euro!
- » Industria bankare rezulton sektori më i besuar nga të gjithë sektorët dhe institucionet e tjera të vendit. Gjithashtu, kjo gjetje u konfirmua nga sondazhi i kryer nga IDRA në nivel kombëtar.
- » AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi dhe miratoi platformën për rigjallërimin e kreditimit.
- » Në kuadër të edukimit financiar, AAB-ja organizoi një udhëtim me 20 gazetarë të mediave të ndryshme ne Torino për njohjen me zhvillimet bankare.
- » AAB-ja mori pjesë në Kuizin Evropian të Parasë, ku ekipi nga Shqipëria zuri vendin e 7-të dhe AAB-ja u nderua me një kupë të veçantë nga EBF.
- » Në bashkëpunim me VISA dhe Mastercard, u organizuan dy fushata ndërgjegjësuere për përdorimin e kartave.
- » Për trajnimin e punonjësve të industrisë bankare, AAB-ja organizoi 28 trajnime, në bashkëpunim me 7 partnerë, ku u trajnuan 535 punonjës. Për herë të parë trajnime u kryen edhe në qytete të tjera përveç Tiranës.

Listën më të detajuar ju mund ta gjeni duke shfletuar këtë publikim, por ajo që dua të nënvizoj është fakti se AAB-ja, nëpërmjet organizimeve me standarde të larta, profesionale, nëpërmjet përfaqësimit profesional në çdo tavolinë, ka rritur më shumë praninë e saj në shoqëri dhe është bërë një partner i besueshëm i zërit të bankave me institucione publike vendase dhe institucione ndërkombëtare me reputacion.



Viti 2019 ishte një vit i suksesshëm dhe reflektues. 20 vjet janë mjaftueshëm për të kërkuar ndryshe, me një përshtatje ndaj zhvillimeve të reja dhe me ritëm tjetër.

Prandaj edhe ne vendosëm të ndryshojmë statutin dhe organizimin e AAB-së, për të cilat po punohet gjatë vitit 2020.

AAB-ja do të mbetet gjithmonë një organizatë jo-fitimprurëse referencë për këdo, e hapur, bashkëpunuese dhe e vlerave të pacenuara.

Ju uroj lexim të këndshëm!

Me respekt,
Silvio Pedrazzi
Kryetar

A handwritten signature in black ink, which appears to read 'Silvio Pedrazzi'. The signature is fluid and cursive, written over a white background that is part of the overall graphic design.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Asambleja e Anëtarëve*

Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i AAB. Vetëm përfaqësuesi(t) e emëruar si duhet të anëtarëve mund të marrin pjesë në takimet e Asamblesë së Anëtarëve.

Në fund të vitit 2019, Asambleja e Anëtarëve përbëhej nga 12 anëtarë. Lista e mëposhtme përshkruan në detaje Bankat Anëtare të AAB-së dhe të Asamblesë së Anëtarëve:

Alpha Bank Albania / Georgios Papanastasiou, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Amerikane e Investimeve / Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Kombëtare Tregtare / Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm & Anëtar Bordi

Banka Credins / Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm

Banka e Parë e Investimeve Albania / Bozhivar Torodov, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Intesa Sanpaolo Albania / Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Procredit Albania / Agan Azemi, Anëtar i Bordit Drejtues
Mirsad Haliti, Anëtar i Bordit Drejtues

Banka Raiffeisen Albania / Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm

Banka OTP Albania / Bledar Shella, Drejtor i Përgjithshëm

Banka e Tiranës / Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm

Union Bank / Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm

United Bank of Albania / Muhamed Prlja, Drejtor i Përgjithshëm

* sipas dhjetorit 2019

ANËTARËT E BORDIT DREJTUES*



Silvio PEDRAZZI

Kryetar

Drejtor i Përgjithshëm

Banka Intesa Sanpaolo Albania



Maltin KORKUTI

Zëvendës Kryetar

Drejtor i Përgjithshëm

Banka Credins



Andi BALLTA

Anëtar

Drejtor i Përgjithshëm

Banka Amerikane e Investimeve



Georgios PAPANASTASIOU

Anëtar

Drejtor i Përgjithshëm

Alpha Bank Albania



Dritan MUSTAFA

Anëtar

Drejtor i Përgjithshëm

Banka e Tiranës

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Anëtarëve për një mandat dy vjeçar. Ajo përbëhet nga pesë anëtarë, tre prej të cilëve zgjidhen nga gjashtë banka të renditura të parat me pjesën më të madhe të totalit të aktiveve të sektorit bankar, dhe dy anëtarë të tjerë zgjidhen nga bankat e tjera anëtare.

Anëtarët që kanë përfunduar mandatet e tyre kanë mundësi të rizgjidhen.

* sipas dhjetorit 2019

SEKRETARIATI

Veprimtaritë e përditshme të Sekretariatit drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Bordi Drejtues. Disa nga detyrat e Sekretariatit, të cilat menaxhohen nga Sekretari i Përgjithshëm, janë:

- Të zbatojë vendimet e Asamblesë.
- Të sigurojë që anëtarët të njoftohen për vendimet e Asamblesë së Anëtarëve dhe të Komitetit Ekzekutiv dhe që këto vendime të zbatohen si duhet.
- Të përmbushë detyrat që i janë ngarkuar nga Komiteti Ekzekutiv.
- Të përfaqësojë AAB-në në organet qeveritare, në gjykatë dhe me palë të treta (sipas autorizimeve të dhëna), në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të vendosë në zbatim buxhetin vjetor dhe planin e biznesit.
- Të hartojë informacione që do të publikohen nga Shoqata dhe t'ia përcjellë këto informacione Komitetit Drejtues.
- Të mbikëqyrë llogaritë e AAB-së dhe të bashkëpunojë me audituesin.
- Të hartojë dhe të nënshkruajë pasqyrat financiare të AAB-së.



Spiro BRUMBULLI

Sekretari i përgjithshëm
i AAB-së

Z. Spiro Brumbulli aktualisht është Sekretari i përgjithshëm i AAB-së.

KOMITETET TEKNIKE DHE KRYETARËT*

- Komiteti i Sigurisë së Bankës – Bajram Ibraj, Banka Intesa Sanpaolo Albania
- Komiteti i Kartave – Erion Maxhari, Banka e Parë e Investimeve Albania
- Komiteti i Përputhshmërisë – Nevila Kovaci, Banka Intesa Sanpaolo Albania
- Komiteti i Burimeve Njerëzore – Valbona Zeneli, Banka Raiffeisen Albania
- Komiteti i Sigurisë së Informacionit – Dritan Gucaj, Banka OTP Albania
- Komiteti i Auditit të Brendshëm – Dorida Stambolla, Banka Raiffeisen Albania
- Komiteti Ligjor – Veronika Prifti, Banka Amerikane e Investimeve
- Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun – Lutjana Konomi, Banka e Parë e Investimeve Albania
- Komiteti i Sistemeve të Pagesave – Najada Xhaxha, Banka e Tiranës
- Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar – Suela Totokoci, Banka Intesa Sanpaolo Albania
- Komiteti i Menaxhimi të Riskut – Elona Bollano, Banka Kombëtare Tregtare
- Komiteti i Teknologjisë së Informacionit – Alketa Lamce, Banka Intesa Sanpaolo Albania

* sipas dhjetorit 2019

ANËTARËSIMET E AAB

AAB është anëtare, anëtare e asociuar ose partnere në organizatat e mëposhtme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarësimet Ndërkombëtare

- Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- Forumi i Shoqatave të Bankave INTERBALKAN

Anëtarësimet Kombëtare

- Këshilli Ekonomik Kombëtar
- Këshilli Tatimor
- Këshilli Ekonomik i Bashkisë së Tiranës
- ICC Albania
- Këshilli Kombëtar i Punës
- Komiteti i Sistemit Kombëtar të Pagesave

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE TË AAB-SË NË VITIN 2019

- Asambleja e Anëtarëve zhvilloi 3 takime dhe Komiteti Ekzekutiv zhvilloi 4 takime.
- U publikua me sukses plani 3-vjeçar i biznesit 2017-2019, i cili u hartua për herë të parë. Një nga shtyllat strategjike të këtij plani biznesi ishte rikuperime i Reputacionit.

Rezultati i sondazhit të kryer nga IDRA Research & Consulting në nëntor 2019, e renditi sektorin e industrisë bankare si sektorin më të besueshëm!

- AAB-ja festoi përvjetorin e saj të 20-të.
- U organizua Konferenca për “Bankat për Zhvillim të Qëndrueshëm”.
- Me kontributin e përfaqësuesve të AAB-së, gjatë takimit të Komitetit të Sistemit Kombëtar të Pagesave u zyrtarizuan dy propozime: hapja e llogarive në distancë (hapje llogarish pa praninë fizike) dhe nevoja e një strategjie kombëtare për edukimin financiar. Këto propozime janë gjithashtu pjesë e Planit të Veprimit të Bankës së Shqipërisë për Rritjen e Kredive.
- Platforma e Bankës së Shqipërisë për rigjallërimin e huadhënies.
- U realizua pjesa e parë e sondazhit për nivelin e besimit në banka dhe produktet dhe shërbimet bankare (i planifikuar për tu realizuar në dy faza).
- Pjesëmarrja për herë të dytë në Kuizin Evropian të Parasë (duke u renditur në vendin e 7-të).

- 7 seminare të organizuara.
- Zhvillimi i mëtejshëm i mediave me shumë kanale për komunikimin me publikun.
- Udhëtim me 20 gazetarë të fushës ekonomike në Torino (Itali) në lidhje me edukimin dhe trajnimin e tyre financiar.
- Dy fushata (me Visa dhe MasterCard) në lidhje me përdorimin e kartave.
- 23 trajnime, 365 punonjës të bankës; bashkëpunim me 10 partnerë.
- Trajnim për herë të parë në gjuhën shqipe në qytete të tjera. 113 punonjës të bankave janë trajnuar në Fier, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë.
- Prej disa muajsh, transport i sigurt i parave cash drejt Aeroportit të Rinasit falë përmirësimit të masave të sigurisë pas ngjarjes së grabitjes që ndodhi brenda aeroportit. Ky ishte një reagim i fortë i AAB-së pas grabitjes së fundit në TIA, çka solli një ndryshim në reagimin e Ministrisë së Brendshme dhe Bankës së Shqipërisë për këtë çështje.
- 10 milionë lekë kontribut për prefekturën e Korçës dhe 200 mijë euro për Qeverinë, në mbështetje të familjeve të dëmtuara nga tërmetet.
- **Marrëdhënie të shkëlqyera me të gjitha institucionet publike** (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave (ADIA/ASD), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK/NAECCS), Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU) etj.) dhe me organizata private. Për më tepër, gëzojmë një vlerësim të lartë nga organizatat ndërkombëtare, si EBF dhe BACEE.

Në muajin shtator, Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi prezantoi një donacion prej 10 milionë lekë për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti që goditi vendin tonë muaj më parë. Përmes këtij donacioni, AAB siguroi mbështetje financiare dhe iu bashkua Fondit të Solidaritetit të Emergjencave Civile në mbështetje të banorëve të prekur për të përballuar dëmet e shkaktuara nga tërmeti në fshatin Qafëzes të Korçës.

Në muajin dhjetor, në solidaritet me situatën e shkaktuar nga tërmeti shkatërrues i 26 nëntorit, Asambleja e Përgjithshme e AAB-së vendosi të dhurojë shumën prej 200.000,00 EUR (dyqind mijë), duke e depozituar këtë shumë në llogarinë e posaçme të hapur dhe menaxhuar nga Qeveria Shqiptare. Kjo ishte një shumë shtesë përtej të gjitha kontributeve të tjera të dhuruara nga anëtarë të veçantë të Shoqatës, bazuar në rregullat dhe politikat e tyre.

Shoqata Shqiptare e Bankave, në bashkëpunim të plotë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë, njoftoi se për çdo transaksion, qoftë në para apo me transferta, në lekë ose në monedhë të huaj, në llogaritë "Kontribut vullnetar për emergjencë", bankat do të operonin me tarifë dhe komision zero, në mbështetje të gjithë atyre që dhuruan kontributin ose ndihmën e tyre për të ndihmuar njerëzit e prekur nga tërmeti.



20 VJET AAB

Një nga momentet kyçe të vitit 2019 ishte festimet në kuadër të përvjetorit të 20 të AAB-së. Me rastin e përvjetorit, në muajin maj në Tiranë u zhvilluan dy aktivitete:

- Ceremonia e 20 vjetorit të themelimit të AAB-së.
- Konferenca “Bankat për Zhvillim të Qëndrueshëm”.

Ceremonia e 20 vjetorit të themelimit të AAB-së

AAB-ja pati nderin të mirëpriste shumë personalitete, duke përfshirë përfaqësues nga ministri të ndryshme, Banka e Shqipërisë, Banka Botërore, UNDP, BERZH, Banka Evropiane e Investimeve, Federata Evropiane e Bankave, institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqata rajonale të bankave, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, universitete dhe media.

Në këtë aktivitet morën pjesë gjithashtu edhe Ministrja aktuale e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrësve, Z. Eduart Shalsi. Në këtë ceremoni përvjetori gjithashtu nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe përfaqësues të organizatave dhe partnerëve të huaj, me të cilët AAB ka krijuar një bashkëpunim të frytshëm ndër vite.

Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi ata për pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet. Në vijim, Znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Maryam Salim, Përfaqësuese e Përhershme e Bankës Botërore në Shqipëri dhe Z. Istvan Lengyel, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE) mbajtën fjalën e tyre përshëndetëse.

Në fjalën e saj, Ministrja Denaj vlerësoi kontributin e vlefshëm të sistemit bankar në Shqipëri në rritjen ekonomike të vendit, duke e cilësuar si një mjet të rëndësishëm për promovimin e kursimeve të shqiptarëve, por edhe për rritjen e ekonomisë së brendshme përmes kreditimit. Ministrja theksoi domosdoshmërinë e vendosjes së kredive në nivelin e pritshëm, pasi “rritja e nivelit të kredive është një domosdoshmëri jo vetëm për zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të vendit, por edhe si një veprimtari kyçe për vetë bankat”.



Mbrëmja vijoi me një atmosferë festive me muzikë, urime dhe përshëndetje mes të ftuarve.

Z. Lengyel nderoi AAB-në me një Certifikatë në emër të BACEE për bashkëpunimin e saj të suksesshëm.

Falë kontributit të veçantë të Kryetarëve të AAB-së, të tillë si: Seyhan Pencabligil, Christian Canacaris, Periklis Drougkas, Ardian Fullani, Edvin Libohova, Gazmend Kadriu, Libero Catalano dhe Kryetari aktual Silvio Pedrazzi, AAB-ja është sot një nga organizatat jofitimprurëse më të organizuara, profesionale dhe më të strukturuar në Shqipëri.

Konferenca “Bankat për Zhvillim të Qëndrueshëm” u zhvillua në 14 maj, në Tiranë.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga bankat anëtare. Gjithashtu, në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të ndryshëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Banka Botërore, UNEP FI, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve, Federata Evropiane e Bankave, shoqatat rajonale të bankave, përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse, qarqet akademike dhe media të ndryshme.



FAKTE DHE SHIFRA PËR 2019 SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI



PBB-ja u rrit me 2.9%



**Raporti i
mjaftueshmerisë së
kapitalit u rrit në 18.3%
nga 12% që është
kërkesa rregullatorë**



**Depozitat e rezidentëve
shënuan 70.4% e PBB-së**



**Norma e papunësisë u
reduktua në 11.2% nga
12.3% në 2018**




Totali i depozitave 1.215 miliardë lekë ose 5.3% më shumë se në 2018



Portofoli i huave për biznes u rrit në 335.9 miliardë lekë ose 4.9% më shumë se në 2018



Portofoli i huave për shtëpi u rrit në 116.8 miliardë lekë ose 6.7% më shumë se në 2018




Portofoli i huave për klientët u rrit në 50 miliardë lekë ose 7.7% më shumë se në 2018



Huatë në sektorin privat vlerësohen në rreth 36.5% të PBB-së, ose 1.2 pikë përqindje më shumë se një vit më parë



Rreth 66% e zgjerimit të kredisë për biznese është kanalizuar në financimin e investimeve



Raporti i kredisë në lekë ndaj kredisë totale u rrit në 48.7% ose 1.5 pikë përqindje më lart se një vit më parë



Për herë të parë në 10 vitet e fundit, treguesi i kredive me probleme ra në nivel një shifror: 8.4%, nga 11.1% në fund të vitit 2018



Numri total i llogarive të klientëve në banka: 2,984,912



Vlera e transaksioneve të Bankingut nga Shtëpia: 960 miliardë lekë ose 8.4% më shumë se një vit më parë



Numri i transaksioneve të Bankingut nga Shtëpia: 3,623,642 ose 24% më shumë se një vit më parë



Llogaritë rrjedhëse me qasje në internet: 441,591 ose 10.5% më shumë se një vit më parë



Numri i kartave për pagesa: 1,206,410




Numri i ATM-ve: 707



Numri i POS-ve: 11,195 ose 2,469 më shumë se një vit më parë



Numri i pagesave me kartë me POS: 5 milionë



Vlera e pagesave me kartë në POS: 26,2 miliardë lekë

SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-SË

Plani i biznesit të AAB-së përfshin pesë shtylla kryesore me objektiva strategjike që mbështesin përmbushjen e vizionit, misionit dhe qëllimit të Shoqatës.

- ✓ **Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe bashkëpunimi me autoritetet**
- ✓ **Transformimi i sektorit bankar**
- ✓ **Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve të bankës**
- ✓ **Edukimi financiar**
- ✓ **Komunikimet, marrëdhëniet me publikun dhe mbrojtja ligjore**

PËRMIRËSIMET E KUADRIT RREGULLATOR

Përgjatë vitit 2019, sektori bankar nëpërmjet Sekretariatit është përfshirë në procesin e konsultimit të disa projektligjeve, një pjesë e të cilëve më pas janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si:

- Ligji “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, i cili synon implementimin e Standardeve të Përbashkëta të Raportimit të hartuara dhe miratuara nga Forumi Global mbi Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria.
- Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, ndryshime të cilat kanë reflektuar rekomandimet teknike të bëra në kuadër të Raundit të 5të të vlerësimit të kryer për Shqipërinë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës.
- Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, i cili ka reflektuar rekomandimet teknike të bëra në kuadër të Raundit të 5-të të vlerësimit të kryer për Shqipërinë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës.
- Ligj nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i cili synon parashikimin në rang ligjor të kompetencave të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe fuqizimin e rolit të saj.
- Projektligji “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, i cili synon përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator për sektorin e fondeve të investimeve dhe të letrave me vlerë dhe obligacioneve.
- Projektligji “Për tregjet e Kapitalit” synon rritjen e potencialit për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, rritjen e mundësisë së financimit të ekonomisë, rritjen e mundësitë për investitorët për fitime më të mira, rritjen e mundësive për ndërmjetësit, rritjen e rentabilitetit të infrastrukturës së tregjeve të kapitalit.
- Projektligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”,

nëpërmjet të cilit rregullohet kryerja e transaksioneve ekonomike të sigurta ndërmjet dy palëve në distancë, pa përfshirjen e ndërmjetësuesve ose palëve të treta si garantues të besueshmërisë.

- Projektligjet në Paketën Fiskale 2020: (i) projektligji “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” (fiskalizimi) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, i cili synon reduktimin e ekonomisë gri dhe përfshirjen në sistem të shumë individëve që aktualisht ushtrojnë aktivitet në të zezë; (ii) projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë

AAB ka qenë e angazhuar në procesin e konsultimit të projekt rregulloreve të Bankës së Shqipërisë, të cilat më pas u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i BSH-së, si vijon:

- Ndryshimet në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të cilat konsistojnë kryesisht në parashikimin e kërkesave shtesë të Bankës së Shqipërisë për subjektet aplikuese, gjatë procesit të licencimit, lidhur me integritetin e aksionarëve /ortakëve.
- Ndryshimet në rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.
- Ndryshimet në rregulloret “Për mbikëqyrjen e konsoliduar” dhe “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të kërkesave të autoritetit mbikëqyrës për subjektet, për një administrim më të mirë të rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.
- Ndryshimet në rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës”, të cilat përafrojnë kërkesat e Bankës së Shqipërisë për raportet e kapitalit, përpjesëtimisht me kërkesat e Bazel III.
- Rregullorja e re “Për raportin e mbulimit me likuiditet”, e cila plotëson kuadrin rregullator në fuqi për administrimin e rrezikut të likuiditetit, si dhe përcakton kërkesat për bankat mbi krijimin e një rezerve likuiditeti që në kushte të stresuara të likuiditetit.
- Udhëzimi i ri “Për stres testet e bankave”, i cili përcakton kërkesat dhe metodologjitë mbi kryerjen e stres testeve nga bankat, si pjesë e procesit të tyre të administrimit të rreziqeve.
- Ndryshimet në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, të cilat janë në linjë me rregulloren e re të sipërpërmendur dhe që synojnë forcimin e kriterëve të klasifikimit dhe provigjionimit të kredive të ristrukturuara, pas datës 1 janar 2021.
- Rregullorja “Për trajtimin jashtë-gjyqësor nga bankat të kredimarrësve në vështirësi financiare”, e cila synon të nxisë trajtimin e kredimarrësve në vështirësi financiare, nëpërmjet një bashkëpunimi të strukturuar dhe eficient ndërmjet bankave.
- Rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, e cila parashikon përdorimin e shtesës konservuese të kapitalit, të shtesës kundër-ciklike të kapitalit, të shtesës së kapitalit për bankat sistemike dhe të shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik, si instrumente të politikës makroprudenciale.

BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET

Tryezat e rrumbullakëta

Më 6 dhjetor, u bashkë-organizua një tryezë e rrumbullakët me Korporatën Ndërkombëtare të Financave (IFC) dhe me mbështetjen e SECO. Nën temën **Rigjallërimi i huadhënies dhe reduktimi i NPL-ve**, ky aktivitet u realizua pas bashkërendimit për zbatimin e “Platformës për rigjallërimin e kredive” të miratuar midis Bankës së Shqipërisë dhe AAB-së.

Më pas, diskutimet u përqendruan në identifikimin e masave të ndërmarra që ndihmojnë në reduktimin e rrezikut të kredisë dhe krijimin e kushteve më të mira për rritjen e nivelit të kredive. Gjithashtu, në këtë aktivitet morën pjesë edhe Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, Z. Deniz Deralla dhe Këshilltari i IFC-së, Z. Ervin Mete. Kjo platformë me objektiva konkrete për rigjallërimin e huadhënies në ekonominë shqiptare përfshinë në fushëveprimin e saj Bankën e Shqipërisë dhe sistemin bankar me qëllim promovimin e huadhënies.





TRANSFORMIMI I SEKTORIT BANKAR

Konferencat

Konferenca “Bankat për Zhvillim të Qëndrueshëm” u zhvillua në 14 maj, në Tiranë dhe solli së bashku institucione me reputacion ndërkombëtar, politikë-bërës në nivel kombëtar dhe institucione financiare për të diskutuar zhvillimet e fundit me një gamë më të gjerë temash mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe industrisë bankare për një zhvillim të qëndrueshëm, në këtë konferencë morën pjesë shumë anëtarë të shoqatave rajonale të bankave.

Punimet e kësaj konference u hapën nga Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania. Gjithashtu, në seancën prezantuese të konferencës, pjesëmarrësit u mirëpritën nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko.



Konferenca u organizua në dy panele.

Paneli i parë u moderua nga Z. Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar Bordi, Banka Kombëtare Tregtare, dhe u përqendrua në rolin dhe përgjegjësitë për një të ardhme të qëndrueshme. Zonja Puleng Tumelo, Ndjwili-Potele, Koordinatorë për Projektet Bankare, UNEP FI prezantoi “Parimet për Bankingun e Përgjegjshëm: Një mjet për të udhëhequr kreditimin që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm”. Z. Dejan Vasiljev, ekonomist i parë, BERZH, u përqendrua në fushën e financave dhe rritjes së qëndrueshme.

Z. Sebastien de Brouwer, Kryeoficer për Politikën, Federata Bankare Evropiane, EBF, foli për rolin e bankave në financa të qëndrueshme dhe perspektivën evropiane. Z. Alessandro Bragonzi, përfaqësuesi i BEI-së për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, solli eksperiencën e grupit BEI në financimin e një të ardhmeje të qëndrueshme. “Bankat në botën sfiduese të ndërmjetësimit financiar” u prezantua nga Z. Milan Mirjanic, partner i asociuar i shoqërisë McKinsey.



Gjatë panelit të dytë të konferencës, pjesëmarrësit trajtuan sfidat në sektorin bankar në rajon, nën moderimin e Z. Sebastien de Brouwer, Kryeoficer për Politikat, Federata Bankare Evropiane, EBF. Më konkretisht, Z. Pierfrancesco Gaggi, Shefi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Shoqatës Italiane të Bankave, ABI, prezantoi zhvillimin e sektorit bankar për forcimin e rimëkëmbjes. Z. Vladimir Vasic, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës së Bankave Serbe, solli përvojën e Serbisë në tregun e NPL-ve dhe rritjen e kreditimit, ndërsa Znj. Charikleia Apalagaki, Sekretare e Përgjithshme e Shoqatës së Bankave Greke, prezantoi pikëpamjet mbi qeverisjen dhe ekuilibrin midis efektivitetit dhe sigurisë në Greqi. Konsolidimi i sektorit bankar në Shqipëri u prezantua nga Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe CEO i Bankës Intesa Sanpaolo Albania, i cili mbylli punimet e kësaj konference.





Projekte

Gjatë muajit shtator, Grupi i Punës i krijuar në kuadër të **Projektit të Byrosë së Kredive** u mbledh dy herë për të diskutuar mbi Kërkesën për Propozim (RFP) të përgatitur nga Sekretariati i AAB-së. Po ashtu edhe Komiteti i Sigurisë së Informacionit pranë AAB-së u mbledh për të diskutuar mbi kërkesat minimale të sigurisë të përfshira në RFP.

Më 14 nëntor, Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi, u takua me Guvernatorin, Z. Sejko. Takimi u përqendrua veçanërisht në projektin e Byrosë së Kredive.

Më 3 dhjetor, Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi, së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së, Z. Spiro Brumbulli, organizuan një takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore, ku u diskutua mundësia e ofrimit të asistencës teknike dhe mbështetjes për krijimin e Byrosë së Kredive.

Seminare

Më datë 12 qershor, AAB dhe Facilitation, një kompani që ofron shërbime dhe programe në fushën e Teknologjisë së Informacionit me fokus në sistemin bankar dhe institucionet financiar, bashkë-organizuan një seminar mbi **Bankingun e Hapur & PSD2** (Direktiva e rishikuar e Shërbimeve të Pagesave). Organizuar në kuadër të Direktivës PSD2 të BE-së, ky seminar kishte si qëllim njohjen e mjedisit të ri bankar që do të krijohet nga revolucioni i Bankingut të Hapur. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga bankat tregtare si dhe shoqëritë Facilitation dhe RedHat.

Më datë 24 shtator, AAB, në bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit pranë Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF) dhe Risi Albania, organizuan seminarin me temë **“Përmirësimi i aksesit në shërbimet financiare për agrobiznesin”**, ku morën pjesë përfaqësues të bankave tregtare, ofrues të shërbimeve këshillimore dhe sipërmarrës bujqësorë. Ky aktivitet ishte pjesë e veprimtarisë së AAB-së në zbatimin e strategjisë së edukimit financiar.

Më datë 24 tetor, AAB, në bashkëpunim me VISA, organizoi një seminar me praninë e dy ekspertëve nga VISA CEMEA: Znj. Anzhela Kashperuk, Menaxhere për Zgjidhjet dhe Z. Srdjan Tutoric, Menaxher i Lartë Klientësh, Visa. Ky seminar mbi **Portofolin e Biznesit të Kartave** u përqendrua në tema të rëndësishme si: Mandatet 3DS; Si bankat mund të rrisin biznesin E-Commerce; Procesi i thithjes së botimeve VBN; Udhërrëfyese i mandateve për përpunimin e produkteve. Të dy ekspertët ndanë përvojat dhe njohuritë e tyre me pjesëmarrësit.

Më datë 29 tetor, AAB, me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit të Fondit Evropian për Evropën Juglindore, (EFSE DF), organizoi një seminar me temë **“Këshilla për jetën”**. Muaji tetor shënoi fillimin e Muajit Evropian të Sigurisë Kibernetike (ECSM), i koordinuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike (ENISA). Fushata e vitit 2019 u përqendrua në tema të ndryshme që trajtonin nevojën e ndryshimit të sjelljes dhe identifikimin e mundësive për të ndihmuar përdoruesit në njohjen e rreziqeve që mbartin teknologjitë e reja. Në katër vitet e fundit AAB ka nxitur ndërgjegjësimin në lidhje me sigurinë kibernetike dhe gjatë muajit tetor ka organizuar forume dhe aktivitete të ndryshme.





Më datë 6 nëntor, AAB, në bashkëpunim me SWIFT, organizoi një aktivitet në lidhje me kontrollin e pagesave SWIFT me pjesëmarrjen e ekspertëve të **SWIFT**, Znj. Gizem Tansu, ICA. Nismat e Përputhshmërisë së Krimit Financiar - EMEA. Përfaqësues të nivelit të lartë nga Departamentet e Operacioneve të Pagesave dhe TI-së së bankave anëtare të AAB-së, morën pjesë në këtë aktivitet për të diskutuar dhe shkëmbyer njohuritë në lidhje me parandalimin e mashtrimit dhe incidentet e fundit në rajon.

Seminari i Akademisë "Greenback"



Më datë 18 dhjetor 2019, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Bankën e Shqipërisë (BSH) prezantuan bashkërisht për herë të parë Akademinë "Greenback" në Shqipëri. Kjo iniciativë shënoi fillimin e punës së komponentit për ngritjen e kapaciteteve të Projektit "Greenback", të zbatuar nga Banka Botërore në Shqipëri, në kontekstin e Programit të Remitancave dhe Pagesave, të financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).



Seminari i parë i Akademisë "Greenback" solli së bashku stafin e marrëdhënieve me klientët nga të gjitha institucionet financiare në Berat. AAB-ja mundësoi pjesëmarrjen e 20 përfaqësuesve të bankave anëtare. Mësimet e nxjerra nga aktiviteti i parë do të zbatohen në një modul trajnimi të standardizuar që Banka Botërore po përgatit për këtë qëllim. AAB dhe BSH do të mundësojnë futjen e këtij moduli në programet ekzistuese të trajnimit për çdo institucion financiar në Shqipëri.



Seminare me Institucionet Shtetërore



Më datë 29 janar, Policia e Shtetit, me mbështetjen e Këshillit Evropian dhe në bashkëpunim me AAB-në, organizoi një **takim mbi bashkëpunimin publik-privat në luftën kundër krimit kibernetik dhe të ardhurave nga krimi kibernetik**. Takimi kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi kërcënimet kibernetike, rreziqet potenciale, pikat e dobëta dhe pasojat, sigurimin e informacionit mbi tendencat e reja dhe aktivitetin kibernetik në vend, si dhe gjetjen e zgjidhjeve për bashkëpunim në parandalimin dhe zbulimin e krimit kibernetik përmes forcimit të bashkëpunimit ekzistues. Në takim morën pjesë përfaqësues të Zyrës së Prokurorisë, Krimit Kibernetik dhe Njësive të Hetimit Financiar në Policinë e Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Njësive të Inteligjencës Financiare (FIU), Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, bankave dhe ISP-ve.



TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE TË BANKAVE

Trajnime në AAB:

- 23 trajnime
- 365 punonjës të bankave
- U bashkëpunua me 10 partnerë

Tema: Shitja e shërbimeve financiare dhe menaxhimi i marrëdhënieve me klientët

Data: 11-13 shkurt

Partnerë: ATTF

Pjesëmarrës: 22

Përshkrimi: TKy kurs u prezantoi pjesëmarrëse një tablo të qartë të teknikave të shitjes që synojnë të shesin shërbime dhe produkte për klientët dhe të menaxhojnë në mënyrë efektive marrëdhëniet me klientët. Trajnimi u mbajt nga Z. Alex Kloos, ekspert i ATTF-së.





Tema: Arbitrazhi ndërkombëtar: rruga drejt zgjerimit të bizneseve ndërkombëtare

Data: 28 shkurt dhe 1 mars 2019

Partnerë: ICC Albania

Pjesëmarrës: 3

Përshkrimi: Seminari dy-ditor u organizua për të gjithë këshilltarët e brendshëm, praktikantët ligjor, arbitrat (e ardhshëm) dhe akademikët e interesuar në fushën e arbitrazhit (ndërkombëtar).

Tema: Seminar mbi procesin e zerimit të NPL-ve dhe ristrukturimi financiar

Data: 12 mars

Partnerë: PwC Shqipëri dhe Kosovë

Pjesëmarrës: 20

Përshkrimi: Aspekte të ndryshme dhe analiza e situatës aktuale e kredive të këqija (NPL) dhe praktikat më të mira në fushën e shërbimeve të ristrukturimit financiar.

Tema: Kapacitetet e shitjes dhe administrimi i shitjeve

Data: 12-9 mars dhe 26-30 mars

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEx)

Pjesëmarrës: 30

Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektiv punonjësit rajonal. U mbajt në gjuhën shqipe dhe u organizua në Fier.

Tema: Menaxhimi i konflikteve dhe zgjidhja e problemeve

Data: 19-20 mars

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEx)

Pjesëmarrës: 13

Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektiv punonjësit rajonal. U mbajt në gjuhën shqipe dhe u organizua në Lezhë.

Tema: Trajnim mbi Transformimin e Shpejtë të Biznesit

Data: 1-2 prill

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEx)

Pjesëmarrës: 14

Përshkrimi: Kursi i trajnimit u siguroi pjesëmarrësve mjetet dhe aftësitë e nevojshme për lulëzimin e organizatave edhe përballë vështirësive.

Tema: Kapacitetet e shitjes dhe administrimi i shitjeve
Data: 9-10 prill
Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)
Pjesëmarrës: 17
Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektiv punonjësit rajonal. U mbajt në gjuhën shqipe dhe u organizua në Korçë.

Tema: Motivimi dhe udhëheqja e një skuadre të suksesshme
Data: 17-18 prill
Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)
Pjesëmarrës: 16
Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektiv punonjësit rajonal. U mbajt në gjuhën shqipe dhe u organizua në Fier.

Tema: Trajnim mbi Bankingun për Individët dhe kanalet e reja të shpërndarjes dhe e-banking
Data: 6-8 maj
Partnerë: ATTF Luksemburg
Pjesëmarrës: 18
Përshkrimi: Ky trajnim tre-ditor ofroi një përmbledhje të përgjithshme të strategjisë së shpërndarjes në Bankingun për Individët, ndërthurjen e kanaleve të ndryshme të shpërndarjes dhe transformimin e nevojshëm për të pasur sukses.

Tema: Trajnimi i skuadrave drejtuese
Data: 20-21 maj
Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)
Pjesëmarrës: 15
Përshkrimi: Trajnimi u përqendrua në krijimin e një skuadre autentike: përbërjen e saj, madhësinë dhe formatimin e një skuadre drejtuese.

Tema: Motivimi dhe udhëheqja e një skuadre të suksesshme
Data: 8-9 maj dhe 29-30 maj
Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)
Pjesëmarrës: 24
Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektiv punonjësit rajonal. U mbajt në gjuhën shqipe dhe u organizua në Lezhë dhe Korçë.





Tema: Rritja e rolit të Drejtorit të Auditit të Brendshëm në organizatë

Data: 22-23 maj

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)

Pjesëmarrës: 14

Përshkrimi: Ky seminar theksoi domosdoshmërinë që Drejtorët e Auditit të Brendshëm të përmirësojnë dhe zhvillojnë aftësi dhe kompetenca si për shembull aftësia për të krijuar dhe mbajtur lidhje të forta me palët e interesit.

Tema: Përputhshmëria me tregtinë ndërkombëtare

Data: 18 qershor

Partnerë: ICC Albania

Pjesëmarrës: 2

Përshkrimi: Seminari kishte si qëllim informimin e pjesëmarrësve mbi format e ndryshme të përputhshmërisë tregtare si klasifikimi tarifor, kontrollet e eksportit dhe embargot, në mënyrë që të minimizohen rreziqet dhe kostot e mundshme për shoqëritë.

Tema: Njohja dhe auditimi i sigurisë kibernetike

Data: 20-21 qershor

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)

Pjesëmarrës: 8

Përshkrimi: Trajnimi dy-ditor synonte njohjen me rreziqet dhe sfidat në zhvillim të sigurisë kibernetike, si dhe problemet dhe zgjidhjet për të kuptuar dhe audituar sigurinë kibernetike në botën digjitale. Trajnimi u përqendrua në sfidat themelore të sigurisë kibernetike, vlerësimin e pjekurisë kibernetike dhe identifikimin e pikave të dobëta, mënyrat efektive për zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë kibernetike, roli dhe detyrat kryesore të profesionistëve të sigurisë së TI-së, auditorëve të brendshëm dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në këtë kontekst. Në aktivitetet morën pjesë pjesëmarrës nga bankat anëtare.

Tema: Bazat e Bankingut Ndërkombëtar të Financave të Tregtisë Dokumentare për Zyrat Mbështetëse

Data: 25-26 qershor
Partnerë: ICC Albania dhe BERZH
Pjesëmarrës: 27

Përshkrimi: Ky seminar u organizua për bankat lokale. Temat e trajtuara lidheshin me Operacionet e Zyrave Mbështetëse, si sinkronizimi i transaksioneve me kontratat e shitjeve të importit-eksportit të klientëve në bazë të parave të depozituara (depozitat) apo tituj të tjerë, hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të transaksioneve dokumentare, përpunimi dhe përfundimi i transaksioneve me shkëmbime mesazhesh SWIFT dhe standardet e kontrollit të dokumenteve të paraqitura me instrumentet e dokumentacionit.

Tema: Siguria teknike dhe menaxhimi i instrumentit të gjurmimit

Data: 9 qershor
Partnerë: Tirana International Airport
Pjesëmarrës: 25

Përshkrimi: Ky trajnim është i detyrueshëm për të gjithë zyrtarët që hyjnë në rrugë ajrore gjatë orarit ditor të punës.

Tema: Kapacitetet e shitjes dhe administrimi i shitjeve

Data: 25 – 26 qershor
Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)
Pjesëmarrës: 12

Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektiv punonjësit rajonal. U mbajt në gjuhën shqipe dhe u organizua në Gjirokastër.

Tema: Auditimi i thesarit

Data: 24-25 shtator
Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)

Pjesëmarrës: 14

Përshkrimi: Trajnimi kishte si qëllim sigurimin e njohurive të specializuara mbi funksionin e auditimit të thesarit, si dhe të kuptuarit e thelluar të operacioneve të thesarit dhe identifikimin e rreziqeve themelore.





Tema: Inovacioni në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore

Data: 10-11 tetor

Partnerë: AIMS International Albania

Pjesëmarrës: 10

Përshkrimi: Trajnimi u ndërmjetësua nga Z. Torsten Miland, Partner Menaxhues i AIMS International Danimarkë, dhe Shef i Përgjithshëm i skuadrës së Shërbimeve Praktike Financiare dhe Profesionale të AIMS.

Tema: Skuadrat drejtuese dhe menaxheri si trajner

Data: 21-22 dhe 23-24 tetor

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIE)

Pjesëmarrës: 21

Përshkrimi: Këto dy trajnime ishin pjesë e programit për zhvillimin e menaxherëve të linjës në bankat tregtare.

Tema: Menaxhimi i Rrezikut: Menaxhimi i Aktivit dhe Pasivit

Data: 23-25 tetor

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrës: 19

Përshkrimi: Qëllimi i trajnimit ishte t'u siguronte pjesëmarrësve një përmbledhje të përgjithshme të teknikave themelore dhe të përparuara në menaxhimin e Aktivit dhe Pasivit.

Tema: Akademia Points of You® në Shqipëri

Data: 25 tetor

Partnerë: Galagan Advisory

Pjesëmarrës: 10

Përshkrimi: Ky seminar mbështetej në njohuri mbi fototerapi, të qenit i pranishëm dhe i ndërgjegjshëm, rrëfimin dhe trajnimin me kapacitetin për të krijuar një lidhje të thellë midis zemrës dhe mendjes.

Tema: Udhërrëfytesë për ndërtimin e një kulture angazhimi

Data: 21 nëntor

Partnerë: Qendra "Lincoln"

Pjesëmarrës: 11

Përshkrimi: Trajnimi kishte si objektive shefat e departamenteve dhe menaxherët.

EDUKIMI FINANCIAR

JAVA EVROPIANE E PARASË

Gjatë javës nga data 25-31 mars 2019, Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MARS), Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe ANFE-së, organizuan aktivitete të ndryshme që synonin përfshirjen e sa më shumë të rinjve, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi çështjet e edukimit financiar.



Nën sloganin: “Tepër i ri për të folur me lekë të vjetra!” aktivitetet synojnë të shtriheshin përtej Javës së Parave, duke u përqendruar në edukimin e shoqërisë në përdorimin korrekt të termit “lek” në ndër-veprimet e përditshme financiare.”

Java e Parave 2019 përfshiu më shumë se **4,000 nxënës dhe studentë**, nga më shumë se **90 shkolla**, nga të gjitha nivelet e vendit.



Java e Parave 2019 nisi në datë **25 mars**. Zëvendës-Guvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë, Znj. Luljeta Minxhozi, Zëvendës-Ministri i Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Znj. Lorena Haxhiu, dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave, Z. Silvio Pedrazzi, mbajtën ceremoninë e hapjes.

Ceremonia vazhdoi me çmimet për fituesit e tre konkurseve, me pjesëmarrjen e rreth 340 nxënësve nga 40 shkolla fillore dhe të mesme.

- Konkursi i 1-rë i organizuar në kuadër të kësaj Jave mbante moton “Mëso. Kurse. Fito”, ku nxënës të gjashtë të shkollave 9-vjeçare ishin ftuar të merrnin pjesë me projektet e tyre origjinale. Konkursi u organizua me mbështetjen e Bankës Kombëtare Tregtare.
- Tema e konkursit të dytë mbi foto-montazhin ishte: “Tepër i ri për të folur me lekë të vjetra: një 0 më shumë bën ndryshimin”, me pjesëmarrjen e nxënësve të klasave të nënta të shkollave 9-vjeçare. Konkursi u organizua me mbështetjen e Bankës Credins.
- Konkursi i 3-të ishte për videon më të mirë, ku nxënësit e gjimnazeve u ftuan të prezantojnë mesazhet e tyre origjinale për temën “Shumë të rinj për të folur në lekë të vjetra”, me mbështetjen e Bankës Amerikane të Investimeve.
- Esetë më të mira me temë “Riemërtimi i lekut: analiza socio-linguistike e një gabimi 55-vjeçar”, e cila u drejtohej studentëve të degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe “Riemërtimet: shembuj nga historia dhe rasti i Shqipërisë”, u mbështetën nga Banka Intesa Sanpaolo Albania.



Më datë **26 mars**, u organizua hapja e programit “Edukimi i punëkërkuesve të rinj në sektorin bankar”. Aktiviteti u mbajt në ambientet e UET-së.

Më datë **28 mars**, për të dytin vit radhazi, u organizua Kuizi Evropian i Parave, në të cilin afro **350 nxënës të shkollave fillore nga 59 shkolla** në të gjithë Shqipërinë garuan drejtpërdrejt në një konkurs të drejtpërdrejtë kombëtar të organizuar përmes platformë mësimore në internet Kahoot! Skuadra fituese përfaqësoi Shqipërinë në finalen evropiane të zhvilluar më 7 maj. Për të dytin vit radhazi, pjesëmarrja e ekipit shqiptar në Kuizin Evropian të Parave, një konkurs ndërkombëtar i shkrim-leximit financiar që tërheq më shumë se 100 000 studentë nga 28 vende evropiane, u bë i mundur falë mbështetjes së AAB-së dhe bankave anëtare. Skuadra shqiptare zuri vendin e shtatë.

Aktiviteti u financua nga: Alpha Bank Albania, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins, FIBank Albania, Banka Intesa Sanpaolo Albania, Banka Raiffeisen, Banka Procredit, Banka Societe Generale Albania, Banka e Tiranës.

Më datë **29 mars** u zhvillua Biseda Novatore “Nga aplikimi për financim personal te biznesi”. Themeluesi i MoneyCoach mbajti një prezantim mbi aplikimin për promovimin e ideve novatore në funksion të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare.

Po ashtu, gjatë javës u organizuan leksione të hapura, gara, vizita në muzeun e Bankës së Shqipërisë dhe klasa të hapura.

EDUKIMI FINANCIAR

AAB U NDERUA ME NJË ÇMIM TË VEÇANTË

Gjatë finales së vitit 2019 të Kuizit Evropian të Parave, Federata Evropiane e Bankave (EBF) nderoi Shoqatën Shqiptare të Bankave, me çmimin e veçantë “Njohje e veçantë për Shqipërinë: E vogël, por e shkëlqyer!”

TAKIMI ME ANFE-NË

Më datë 13 qershor u organizua mbledhja e ANFE-së, e udhëhequr nga shoqata e Sigurimit të Jetës dhe Pensioneve. Në takim u bë prezantimi i projektit “Greenback” 2.0 të Bankës Botërore me temë “Edukimi Financiar - një portë për zhvillimin e qëndrueshëm”, dhe u diskutuam kontributet e gjitha organizatave në krijimin e një libri për mësuesit për të mbështetur lëndën e detyrueshme “Ekonomia 12” për shkollat e mesme. Anëtarët themelues ranë dakord të bashkëpunojnë në aktivitetet e edukimit financiar mbi javët e festimeve të veçanta gjatë vitit, siç janë java e parave, java e investimeve, java e sipërmarrësve, etj.

Agjenda e takimit të organizuar në datë 25 shtator përfshinte organizimin e aktiviteteve në Ditën Botërore të Investitorëve, aktivitetin me nxënës të shkollave të mesme nën sloganin “Le të flasim në gjuhën tuaj” mbi terminologjinë e tregut financiar dhe nevojën për një strategji kombëtare të edukimit financiar dhe çështje të tjera informuese.



FLETËPALOSJE PËR FERMERËT

AAB nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “Finance in Motion” GmbH për bashkë-sponsorizimin e botimit të një broshure edukuese në lidhje me huatë në fushën e bujqësisë dhe shpërndarjen e broshurës tek një grup aktorësh të interesuar në Shqipëri. Kjo broshurë e cila është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze, adreson parimet themelore dhe rreziqet që lidhen me kreditimin e bujqësisë. Falë bankave anëtare, materiali është përshtatur me specifikat e vendit.



VIDEO INFORMUESE

Në muajin janar, AAB publikoi për herë të parë videon e radhës të serialit “Banka Ime” mbi “Kartat pa kontakt”.



KOMUNIKIMET, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MBROJTJA LIGJORE

Angazhimi i fortë i Shoqatës për të përmirësuar profilin e profesionit në industrinë bankare dhe njohja e anëtarëve përfshin një gamë të gjerë aktivitete.

Gjatë këtij viti, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së janë ftuar shpeshherë të mbajnë fjalime ose të marrin pjesë në të tilla aktivitete në Shqipëri dhe kudo në Evropë, me qëllim shpalosjen e këndvështrimit të këtij sektori lidhur me çështje kryesore aktuale.

Përfaqësuesit e AAB kanë vazhduar të jenë pjesë e disa tryezave të rrumbullakëta dhe forumeve, duke prezantuar kështu pozicionin e AAB për çështje të lidhura me to.

Aktivitetet e AAB-së u pasqyruan gjerësisht në media gjatë vitit 2019 dhe Sekretari i Përgjithshëm dha më shumë se 30 intervista gjatë gjithë vitit në lidhje me imazhin e industrisë bankare, tarifën e përmbaruesve privatë, NPL-të, edukimin financiar, zhvillimet e pagesave elektronike, uljen e përdorimit të parave cash dhe ekonominë joformale, pasojat pas tërmetit, etj.

Po ashtu, kryetari i komitetit teknik të AAB-së dhe i Komitetit të Kartave pranë AAB-së ndanë disa informacione për çështje specifike si: pastrimi i parave, shmangia e mashtrimeve me kartat dhe përdorimi i kartave.

AKTIVITETET ME GAZETARËT E EKONOMISË:

Kryetari i AAB-së takon përfaqësuesit e medias

Në datë 24 prill, me ftesë të Kryetarit të AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi dhe me pjesëmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm, Z. Spiro Brumbulli, në ambientet e AAB-së u mbajt një takim me përfaqësuesit e mediave të cilët mbulojnë lajmet ekonomike. Takimi u zhvillua në kuadrin e një marrëdhënie të qëndrueshme, të frytshme dhe koordinim me mediat, me qëllim një informim sa më të mirë.

Gjatë fjalës së tij Z. Pedrazzi vuri në dukje se AAB është e angazhuar të sqarojë disa nga çështjet e diskutuara në media në lidhje me veprimtarinë e kryer nga bankat në monedhëtë huajdheme menaxhimin e vlerës së parave në sistemin bankar. Takimi u vlerësua si një mjet efektiv komunikimi.

Udhëtim trajnimi me gazetarë të ekonomisë

Udhëtimi i përvitshëm me gazetarët e ekonomisë u organizua në datat 20-22 tetor në qytetin e Torinos, Itali, me mbështetjen e Bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania & Intesa Sanpaolo Group. 17 gazetarë ekonomie të medias së shkruar, asaj elektronike dhe të medias on-line patën mundësinë të shkëmbejnë informacione me ekspertë të sektorit bankar. Njohja me lehtësirat novatore të Intesa Sanpaolo Group synonte një njohje më të mirë të mënyrës së funksionimit të një grupi bankar që është lider në Itali.



PUBLIKIME

Revista "Bankieri" (30, 31, 32, 33)

Katër botime të revistës "Bankieri" u përgatitën dhe u botuan gjatë vitit 2019. Ato përmbanin artikuj të shkruar nga ekspertë bankarë, akademikë, përfaqësues të biznesit, etj. Revistat mund të shkarkohen në internet dhe në profilet përkatëse në rrjetet sociale.



Raporti vjetor - 2019



Raportet vjetore mbi CSR-në: Bankat për shoqërinë - 2019



Studimi “Besimi dhe perceptimi i klientëve kundrejt bankave dhe sektorit bankar”



Sondazhi, i realizuar për të parën herë, u përqendrua në produktet dhe shërbimet bankare, duke vlerësuar njëkohësisht edhe ecurinë e procesit të digjitalizimit në shërbimet bankare.

Në sondazhin e kryer nga IDRA Research & Consulting, u analizuan rezultatet e fazës së parë, duke u bazuar në pyetësorë të plotësuar nga mbi 600 klientë të bankave tregtare përmes një platforme anketimi në internet.

Më 23 shtator 2019, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) organizoi një aktivitet për të prezantuar gjetjet e këtij sondazhi të parë. Në të morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, Bankës së Shqipërisë, shoqatave, bankave anëtare dhe medias.

Sondazhi vijoi me një fazë të dytë dhe të fundit dhe është planifikuar të realizohet nga Shoqata Shqiptare e Bankave në baza dy-vjeçare.

FUSHATA PËR NDËRGJEGJËSIMIT NË PËRDORIMIN E KARTAVE

Gjatë vitit në shqyrtim, AAB zhvilloi dy herë fushatën edukuese të rritjes së ndërgjegjësimit, me mbështetjen e VISA dhe Mastercard përkatësisht, për të ulur përdorimin e parave cash dhe për të rritur përdorimin e këtij instrumenti pagese, duke edukuar mbajtësit e kartave në Shqipëri mbi përfitimet e tyre. Fushata përmbante spote promocoionale në televizor dhe radio, dhe do të përfshinte platforma të ndryshe në mediat sociale.




Përdorni kartat bankare
në çdo shpenzim tuajin!



MEDIAT SOCIALE

Duke marrë parasysh madhësinë e diapazonit të mediave sociale, gjendemi përballë një tjetër sfide pasi çdo kanal mediatik ofron rezultate të ndryshme të dhënash. Në kufijtë e përcaktimit të suksesit, AAB tashmë është në gjendje të gjykojë se çfarë ka funksionuar, çfarë jo, dhe si të përshtatë më së miri informacionin në të ardhmen.



KOMITETET TEKNIKE

ÇËSHTJET KRYESORE DHE ARRITJET

Komiteti i Sigurisë së Bankës

Në muajin janar, Sekretariati organizoi dhe zhvilloi një shkëmbim përvojash ndërmjet Komitetit të Sigurisë së Bankës dhe Kryetarit të Komitetit të Sigurisë së Bankës në Kosovë, Z. Besim Karaqa, në lidhje me rastet e grabitjes së bankave dhe bankomateve dhe masat që janë marrë.

Gjatë vitit, anëtarët e komitetit u përqendruan në grabitjen e armatosur që ndodhi në Rinas, në masat shtesë të sigurisë të marra nga bankat dhe në sigurinë e transportit të vlerave monetare në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Për më tepër, pjesë e diskutimeve ishte zbatimi i kontratës nga shoqëritë e sigurisë fizike në përputhje me Udhëzimin Nr. 130, datë 05.03.2018 për "Shërbime private të sigurisë fizike".

Komiteti i Kartave

Anëtarët e komitetit diskutuan për çështje të një shqetësimi të përbashkët, si p.sh.: fushata sensibilizuese për përdorimin e kartave, problemet e hasura me transaksionet në internet, ndikimi i urdhrave të rinj nga VISA dhe Mastercard, sondazhi për kostot e përpunimit të tregtarëve.

Më datë 10 qershor, anëtarët e komisionit organizuan zgjedhjet dhe si kryetare e re e komitetit u emërua Znj. Erion Maxhari nga FIBank Albania.

Komiteti i Komunikimit & Marrëdhënieve me Publikun

Anëtarët e komitetit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun kanë kontribuar në projektet e edukimit financiar dhe në aktivitetet e Javës së Parasë. Një temë tjetër diskutimi ishte raporti vjetor për aktivitetet e CSR-së të ndërmarra nga bankat anëtare, të raportuara sipas OZHQ-ve. AAB krijoi një model, për të lehtësuar çdo raportim dhe për të bashkëpunuar më tej në një raport të vlefshëm.

Në mbledhjen e mbajtur më datë 11 prill, Komiteti organizoi zgjedhjet. Kryetarja e re e Komitetit është Znj. Lutjana Konomi, përfaqësuese e FIBank Albania.

Komiteti i Përputhshmërisë

Anëtarët e Komitetit të Përputhshmërisë së AAB-së i paraqitën Sekretariatit të AAB-së komente dhe sugjerime lidhur me projektligjin "Për standardet e përbashkëta të raportimit". Sekretariati i AAB-së i dërgoi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë komentet e unifikuara më 17 prill. Gjatë këtij viti, anëtarët diskutuan çështje që lidhen me kuadrin e ri ligjor për Standardet e Përbashkëta të Raportimit si dhe projekt-rregulloren e Bankës së Shqipërisë për pastrimin e parave në lidhje me unifikimin e programit të trajnimit të kërkuar, me ndryshimet e propozuara.

Më 12 nëntor, Komiteti i përputhshmërisë së AAB-së zgjodhi kryesinë e re të komitetit dhe Z. Markelian Riska, përfaqësues i Intesa Sanpaolo Bank Albania u emërua si Kryetar.

Komiteti i Burimeve Njerëzore

Më 17 maj, u organizua një mbledhje e komitetit, për të diskutuar pjesëmarrjen e bankave anëtare në Sondazhin e vitit 2019 të Korn Ferry për Kompensimin dhe Përfitimet për Tregun Bankar në Shqipëri. Anëtarët diskutuan rreth një parashikimi se sa Banka mund të merrnin pjesë në këtë Sondazh, me qëllim marrjen në konsideratë të qëndrueshmërisë së të dhënave që mund të sigurohen nga to.

Më 16 tetor, u mbledhën anëtarët e komitetit. Në rolin e kontribuuesit dhe mbështetësit kryesor të trajnimeve të organizuara nga AAB-ja për punonjësit e bankave gjatë vitit, komiteti u përqendrua në planifikimin e trajnimeve afatgjata. Për më tepër, aktivitetet për vitin 2020 si partneriteti me universitetet në lidhje me organizimin e mësimave në kuadrin e edukimit financiar, programi vjetor i trajnimit të njësive të bankës përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, etj. ishin temat kryesore të diskutuara gjatë gjithë vitit në shqyrtim.

Më 10 dhjetor u mbajtën zgjedhjet për kryesinë e Komitetit të Burimeve Njerëzore të AAB-së. Pas procesit të votimit, Znj. Valbona Zeneli nga Banka Raiffeisen Albania u emëruar si kryetare e re.

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Anëtarët festuan së bashku muajin e promovimit ndërkombëtar të funksionit të auditimit të brendshëm. Në kuadër të aktiviteteve të organizuara me pjesëmarrjen e disa prej anëtarëve të komitetit, më 28 maj u mbajt një leksion i hapur ku morën pjesë studentë të departamentit Kontabilitet-Financë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës. Leksionin e mbajti Z. Ilir Rudi, Drejtor i departamentit të auditit të brendshëm në ABI Bank.

Duke marrë parasysh përfundimin e afatit të mandateve të kryetarit dhe dy nënkryetarëve, zgjedhjet e komitetit u mbajtën në 16 qershor. Znj. Dorida Stambolla nga Banka Raiffeisen Albania u emërua kryetare e re e komitetit.

Komiteti i Sigurisë së Informacionit

Komiteti i dërgoi një kërkesë AKCESK-së për të krijuar një kontakt rezervë për sistemin e raportimit të menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike. Bankat rishikuan bashkë me autoritetin kriteret e vlerësimit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme në lidhje me sigurinë kibernetike.

Më 2 gusht u mbajtën zgjedhjet dhe si kryetari i ri u emërua z. Dritan Gucaj nga OTP Bank Albania.

Komiteti Ligjor

Pas mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", i ndryshuar, Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut organizoi një tryezë të gjerë publike për këtë projektligj, të martën, më 26 mars 2019. Përfaqësuesit e Sekretariatit të AAB-së dhe përfaqësuesit e komitetit juridik morën pjesë në këtë tryezë, ku u paraqitën shqetësimet dhe sugjerimet kryesore të sektorit bankar në lidhje me projektligjin.

Gjatë vitit 2019, Komiteti Ligjor u përfshi tërësisht në projektligjet: "Për faturat dhe sistemin e monitorimit të transaksioneve"; "Për ndërmarrjet e investimeve kolektive"; si dhe në identifikimin e çështjeve kryesore dhe propozimet për Rritjen e kredive.

Më 6 nëntor u mbajtën zgjedhjet dhe Znj. Veronika Prifti nga Banka Amerikane e Investimeve u emërua si kryetare e re.

Komiteti i Riskut

Gjatë vitit, anëtarët e Komisionit u përqendruan në rregulloren "Për raportin e mbulimit të likuiditetit" dhe kontribuan në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.

Më 6 korrik u mbajtën zgjedhjet dhe Znj. Elona Bollano nga Banka Kombëtare Tregtare u emërua si kryetare e re.

TAKIME TË TJERA **GJATË 2019**

Shoqata organizoi një seri takimesh që mbledhën në një vend vendimmarrësit e lartë nga bankat anëtare dhe ekspertët nga një gamë e gjerë sektorësh, duke ofruar mundësi unike për dialog dhe shkëmbim të nivelit të lartë në lidhje me tematikat në zhvillim dhe me përparësi.

Takime me institucionet publike

Takim me Ministrin e Brendshëm, Sandër Lleshaj

Më datë 6 shkurt, anëtarët e komitetit ekzekutiv takuan Ministrin e Brendshëm, Sandër Lleshaj. Pjesëmarrësit në takim diskutuan kryesisht për çështje që lidhen me sigurinë në banka si: rastet e sulmeve fizike në bankomate, situatën në vend para zgjedhjeve, kërkesat dhe kontrollin mbi shoqëritë e sigurisë fizike, etj.

Takim me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Eduard Shalsi



Më 27 shkurt, drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare zhvilluan një takim me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Z. Eduard Shalsi. Në fokus ishte përmirësimi i klimës së biznesit. Gjatë takimit, pjesëmarrësit theksuan aspekte të ndryshme si qëndrueshmëria, besueshmëria, mbikëqyrja rregullatore, likuiditeti i bankave dhe domosdoshmëria për kredi të mëtejshme. Për më tepër, ata ngritën shqetësime për disa çështje të ndryshme. Palët shprehën gatishmërinë e tyre për t'i adresuar këto shqetësime dhe për të gjetur një zgjidhje.

Takim me përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore

Më 6 mars, përfaqësuesit e AAB-së u takuan me përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore. Takimi u përqendrua në pagesat e qeverisë, infrastrukturën e pagesave (pagesa switch dhe të çastit).

Takim me përfaqësuesit e DPT-së

Më 23 mars, u organizua një takim me përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Këshilltarët e KPMG morën pjesë në takim dhe diskutuan për efektet e SNRF 9. Pas një komunikimi midis palëve, takimi u mbajt në lidhje me zbatimin dhe miratimin e SNRF 9. DPT-së iu kërkua një qëndrim dhe pas takimit bankave iu dërgua një letër shpjeguese.

Më 11 shtator, u organizua një takim i përbashkët me përfaqësues nga bankat anëtare për të diskutuar projekt-marrëveshjen për kthimin e financimit të TVSH-së për subjekte të ndryshme.

Takimi i Guvernatorit Z. Sejko me sektorin bankar

Më 29 maj, u organizua në ambientet e Bankës së Shqipërisë një takim me temë: “Roli i industrisë bankare në zhvillimin e Shqipërisë në të ardhmen”. Në takimin e organizuar me iniciativë dhe që u kryesua nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko, morën pjesë zyrtarë të lartë të Bankës së Shqipërisë, drejtues të bankave tregtare (drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të përgjithshëm), dhe përfaqësues nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Grupi i Bankës Botërore.



Më 24 korrik, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv (KE) të AAB, të kryesuar nga Kryetari Z. Silvio Pedrazzi, organizuan një takim me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko.

Ky takim, që njihet si “Samiti i Verës”, u mbajt në kuadrin e dialogut tradicional dhe të vazhdueshëm që KE ndërmerr me Bankën e Shqipërisë. Gjatë këtij takimi, Z. Pedrazzi informoi Guvernatorin për zhvillimet e fundit në AAB, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në vendimin për kontributin e AAB-së për të ndihmuar pas pasojave të tërmetit në prefekturën e Korçës dhe në miratimin për të krijuar Byronë e Kredive. Një çështje tjetër e rëndësishme që u trajtue gjatë takimit ishte rregullorja e miratuar në mbledhjen e fundit të Këshillit Mbikëqyrës, “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”, i quajtur ndryshe “Qasja e Tiranës”, e cila është hartuar në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në Planin Ndërinstitucional për masat për uljen e kredive të këqija. Përfaqësuesit e AAB-së shprehën angazhimin e tyre për konkretizimin dhe ndjekjen e projekteve të ndërmarra.

Vlerësimi i Riskut Kombëtar

Shqipëria ka realizuar një raund të dytë rishikimesh të Vlerësimit të Riskut Kombëtar (NRA) për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, një detyrim që rrjedh nga Rekomandimi 1 i Task Forcës së Veprimit Financiar, për të adresuar të metat e gjetura nga Moneyval në vlerësimin e tij të fundit për vendin tonë. Si një institucion i ngarkuar me detyrën e rishikimit të vlerësimit të riskut kombëtar, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave ua dërgoi bankave përmes Sekretariatit të AAB-së këtë projekt-dokument, për të marrë sugjerime. Lidhur me këtë çështje, më 28 qershor u mbajt një takim në ambientet e DPPPP, ku morën pjesë ekspertë të bankave.

Takim pune me Drejtorin e Përgjithshëm të FIU

Më 2 gusht, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u takua me Drejtorin e Përgjithshëm të FIU-së. Takimi u përqendrua në masat që duhen marrë parasysh për të zvogëluar përdorimin e parave cash në vend.

Takime me institucionet ndërkombëtare

Takim me ekipin e MIGA

Ekipi i Agjencisë Shumëpalëshe të Garantimit të Investimeve (MIGA) i Grupit të Bankës Botërore, realizoi një vizitë në Shqipëri në datat 23-24 janar. Qëllimi i misionit ishte të kryente një vlerësimin e garantuar të MIGA-së për një nga projektet e bankave tregtare në Tiranë. Në këtë kuadër, më 23 janar, ekipi përbëhej nga: Persephone Economou, Zyrtare e Lartë e Menaxhimit të Riskut, Atia Byll-Kataria, Specialiste e Lartë e Zhvillimeve Mjedisore dhe Sociale (MIGES) dhe Juan David Reyes Trujillo, Analist për Operacionet (MIGOP), të cilët u takuan me Z. Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB-së, në mënyrë që të informoheshin për zhvillimet e fundit e sektorit bankar në Shqipëri.

Takim me misionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian (ECFIN)

Një mision nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian, ECFIN, vizitoi Tiranën për të diskutuar me autoritetet shqiptare Programin e Reformës Ekonomike 2019-2021 (ERP).

Për këtë qëllim, ekipi u takua dy herë me Kryetarin e AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi dhe Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së, Z. Spiro Brumbulli më 20 shkurt dhe 21 nëntor, ku u diskutua Programi i Reformës Ekonomike 2019-2021 & 2020-2022 (ERP) për Shqipërinë dhe reformat strukturore për të cilat po punon Shqipëria, duke përfshirë zhvillimet në sektorin privat dhe mjedisin e biznesit.

Takim me ekipin e BERZH

Më 27 mars, ekipi i BERZH u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së. Agjenda përfshinte: nivelin e vlerësimit të informalitetit dhe ndikimin e tij në ekonominë formale; përpjekjet e fundit (p.sh. inspektimet) kundër informalitetit; Faktorët kryesorë pas pagesave të vazhdueshëm në euro; Pengesat kryesore për shlyerjen më të shpejtë të kredive të këqija.

Programi IOM

Më 18 shkurt, u organizua një takim me ekipin e ekspertëve që punojnë në bashkëpunim të ngushtë me programin IOM "Angazhoni Diasporën Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë" dhe me homologët e tyre përkatës, për të identifikuar, zhvilluar dhe prezantuar një rishikim të plotë të dokumentit të Strategjisë dhe planit të veprimit, duke përfshirë një buxhet të strategjisë. IOM Albania mbështet qeverinë shqiptare në përpjekjet për të mbështetur Grupin Ndërinstitucional të Punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe Planit të Veprimit.

Raport për respektimin e standardeve dhe kodeve (ROSC) Kontabiliteti dhe Auditimi

Më 28 shkurt 2019 u organizua një takim me ekipin e Raportit për respektimin e standardeve dhe kodeve (ROSC) Kontabiliteti dhe Auditimi. Gjatë takimit u diskutuan perceptimet për cilësinë e rregullores dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar, dhe cilësinë e profesionit të kontabilistit dhe audituesit, raportimin financiar bankar dhe perceptimet e bankës si përdorues të pasqyrave financiare.

Projekti pilot "Zhvilluesit e Tregut"

Më datë 13 qershor u organizua një takim me z. Laszlo Buzas, ekspert i ekipit të Bankës Botërore për menaxhimin e borxhit publik, për të diskutuar mbi progresin e projektit "Zhvilluesit e Tregut" i cili synon lehtësimin e tregtimit dytësor të titujve të përzgjedhur të qeverisë, duke prezantuar një qasje të përshtatur për zhvillimin e tregjeve të kapitalit shqiptar.

Mbi pagesat e menjëhershme

Më datë 10 korrik u mbajt një takim informues me përfaqësuesin e CAPSYS, një shoqëri e pavarur programesh kompjuterike dhe shërbimesh këshillimore me qendër në Hungari, që ofron zgjidhje për tregjet e kapitalit dhe zgjidhje bankare, dhe me përfaqësuesit e Shoqatës Kombëtare të Sipërmarrësve dhe Punëdhënësve të Hungarisë. Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u informua

mbi profilin e shoqërisë dhe projektet e saj dhe u diskutua më tej në lidhje me zgjidhjet për pagesat e menjëhershme.

Për tregjet e kapitalit

Më datë 30 korrik, BERZH organizoi një takim me fokus zhvillimet e fundit në sektorin bankar dhe legjislacion në Shqipëri. Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së prezantoi një vështrim të përgjithshëm të sektorit bankar dhe marrëdhëniet e tij me autoritete të ndryshme, përfshirë entet rregullatorë.

Takim me përfaqësuesit e Zyrës së Asistencës Teknike (ZAT)

Më datë 23 tetor, Sekretari i Përgjithshëm u takua me përfaqësuesit e Zyrës së Asistencës Teknike (ZAT), një mision i Departamentit të Thesarit të SHBA. Takimi u mbajt në Drejtorinë e Përgjithshme të AML-së. Përfaqësuesit e OTA-së prezantuan qëllimin e tyre për të ofruar asistencë teknike përmes projektit, me qëllim forcimin e aftësive parandaluese dhe zbatimin e AML-së dhe CFT-së, duke përfshirë të gjithë aktorët e proceseve në vend.

Mbi Planin NPL 2

Më datë 24 tetor u organizua një takim me Misionin "Scoping" të Bankës Botërore për Diagnostikimin e Sektorit Privat në vend. Gjatë takimit u propozua një plan i dytë NPL nga Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, për të marrë mbështetje teknike në hartimin e planit, me fokus në nevojën për të rritur nivelin e huadhënies brenda vendit.

Vërtetësia e dokumenteve elektronike

Më datë 18 dhjetor, SECOM mbajti një prezantim mbi një pajisje për vërtetësinë e dokumenteve të identifikimit si dhe të monedhave. AAB gjithashtu mundësoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave anëtare në aktivitetin e organizuar nga EXPO Click.

Takim me RISI Albania

Më datë 25 janar, Sekretari i AAB-së u takua me përfaqësuesit e Risi Albania, një projekt që lehtëson krijimin e bashkëpunimit publik - privat, për të adresuar barrierat ndaj rritjes. Takimi u përqendrua në bashkëpunimin e mëtejshëm, në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si ditët e hapura midis sektorit të agrobiznesit dhe bankave, duke ofruar mundësi të reja financimi për projekte të reja.

Takimet informuese

AAB-ja u ofron vazhdimisht një bazë njohurish dhe informacione të konsoliduar partnerëve të saj, duke komunikuar rregullisht dhe duke u siguruar që anëtarët dhe bashkëpunëtorët janë të informuar për të gjitha çështjet më të fundit dhe më të rëndësishme. Në mënyrë që përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare të njihen me zhvillimet e tregut financiar dhe të marrin informacion të hollësishëm mbi sektorin bankar në Shqipëri, gjatë vitit, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së organizoi një seri takimesh informuese me përfaqësues nga disa institucioneve ndërkombëtare dhe shoqëri të shërbimeve financiare, udhëheqës në sektorin financiar.

Temat e diskutuara gjatë këtyre mbledhjeve janë: çështjet lidhur me edukimit financiar, zhvillimet më të fundit në sektorin bankar, rritja e kredi-dhënieve, skemat e garancisë së kredive, përmbledhje e përgjithshme e sektorit bankar dhe politikave të industrisë për NVM-të, segmenti i korporatave në Shqipëri, rekomandime të hollësishme për mënyrën e përmirësimit të qasjes dhe përdorimi i shërbimeve financiare, projekti i Byrosë së Kredive, tarifat e përmblyesve, çështjet e huave dhe konsolidimi i mbikëqyrjes bankare, zhvillimet rregullatore, dhe sfidat dhe problemet e tjera me të cilat sektori bankar po përballet kohët e fundit.

Partnerët e AAB-së që morën pjesë në takimet informuese: Grupi i Bankës Botërore; ekipi i Bashkimit Evropian, Korporata Ndërkombëtare e Financave (IFC); Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE); Fondacioni i Bankave të Kursimeve për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SBFIC), Ekipi i Komisionit Evropian (Drejtoria e Përgjithshme e Fajnjësisë dhe Zgjerimit -DG NEAR), Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ekonomike dhe Financiare - DG ECOFIN dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit - DG EMPL; Ambasada Zvicerane; Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave; Shërbimi ekonomik për zonën e Danubit/Ballkanit, CBS "Creative Business Solutions"; shoqëria "Business & Financë Consulting" GmbH (BFC), Banka NLB; Ambasada e Francës në Bullgari.



SHIFRA
RRETH
BANKAVE
ANËTARE

Banka	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	"Aktivet gjithsej (000 lekë)"	"Kreditë neto (000 lekë)"	"Investime në letra me vlerë të Qeverisë (000 lekë)"	"Kapitali i vet (000 lekë)"
 ALPHA BANK	Alpha Bank A.E. 100%	Greqi	78,336,093	35,007,564	10,939,442	9,021,059
 AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit shpk 100%	Shqipëri	77,654,402	24,754,762	31,824,674	9,636,268
 BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. 100%	Turqi	403,955,245	94,037,744	159,511,548	48,834,280
 CREDINS bank	Renis Tershana 21.93% Aleksander Pilo 14.27% B.F.S.E. Holding BV 15.37% Të tjerë (aksionarë që zotërojnë më pak se 5% të aksioneve) 48.43%	Shqipëri Shqipëri Hollandë	221,096,265	102,717,457	67,056,366	17,638,479
 Fibank First Investment Bank	Fibank AD 100%	Bullgari	31,722,865	14,669,657	8,905,701	3,457,903
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A. 100%	Itali	177,566,758	44,864,090	61,557,505	21,631,243
 otpbank	OTP NYRT 100%	Hungari	90,647,369	53,018,547	22,448,698	9,085,051
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA 100%	Gjermani	31,952,136	22,157,380	2,288,243	2,945,593
 Raiffeisen BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH 100%	Austri	223,434,845	94,942,961	54,433,371	27,935,995
 TIRANA BANK	Balfin Shpk 90.12% Komericialna Banka AD Skopje 9.88%	Shqipëri Maqedonia e Veriut	75,900,015	31,179,091	30,865,226	9,672,435
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k. 89.72% Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim 6.74% Individë 3.54%	Shqipëri Britani e Madhe Shqipëri	65,921,742	28,563,011	22,191,512	5,307,883
 Banka e Bashkuar e Shqiperise United Bank of Albania	Islamic Development Bank 77.7% EUROSIG SH.A 9.00% Ithmaar Bank 4.63% Dallah Albaraka Holding Co. 2.32% Business Focus SDN BHD 1.47% Saudi Brother Commercial Co. 0.58% Individë 4.31%	Arabia Saudite Shqiperi Bahrain Bahrain Malajzia Arabia Saudite Arabia Saudite	8,947,296	5,500,594	-	1,762,717
Gjithsej			1,487,135,032	551,412,858	472,022,287	166,928,906

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2019 (1 EUR = 121.77 lekë; 1 USD = 108.64 lekë) (në mijë lekë)

"Depozita (000 lekë)"	"Fitimi neto (000 lekë)"	Nr. i degëve	Nr. i punonjësve	Nr. ATM	Nr. i kartave të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
63,845,679	138,018	33	421	49	54,345	47,264	7,081	1,374	Po	Po	Jo
64,980,154	748,540	23	372	31	20,010	19,084	926	-	Po	Jo	Jo
315,700,945	5,315,245	65	953	93	385,652	311,933	73,719	6,338	Po	Po	Po
189,099,583	1,002,448	58	921	70	170,503	164,580	5,923	1,306	Po	Po	Po
26,588,459	482,480	14	218	29	32,203	28,213	3,990	n/a	Po	në proces	Jo
150,941,624	1,701,875	35	663	53	109,888	109,290	598	653	Po	Po	Jo
66,345,074	926,407	37	454	76	62,672	61,066	1,606	-	Po	Po	Jo
21,540,689	(802,302)	5	111	16	10,835	10,834	1	-	Po	Po	Jo
188,117,072	2,901,441	76	1,300	177	284,779	249,559	35,220	1,294	Po	Po	Po
63,324,971	400,840	35	450	66	70,116	65,553	4,563	216	Po	Po	Jo
51,954,739	748,828	33	428	44	37,124	W30,595	6,529	30	Po	Po	Jo
7,313,310	8,778	6	75	-	1,942	1,942	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
1,209,752,300	13,572,598	420	6,366	704	1,240,069	1,099,913	140,156	11,211	11	9	3

PASQYRAT FINANCIARE TË
SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.....	2
PASQYRA E FLUKSIT MONETAR.....	3
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE.....	5-8

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR DREJTIMIN E SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave ("AAB"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të fluksit monetar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Organizatave jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK për OJF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një

garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri



2 qershor 2020

Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Certified Auditor



SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Pasqyra e Pozicionit Financiar

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

	Shënime	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<u>AKTIVET</u>			
<i>Aktive afatshkurtra</i>			
Arka dhe banka	4	7,075,012	8,325,877
Kontribute të arkëtueshme	5	2,435,400	2,750,371
Shpenzime të parapaguara	6	280,160	280,160
Totali i aktiveve afatshkurtra		9,790,572	11,356,408
 <i>Aktivitet Afatgjata</i>			
Aktivitet e qëndrueshme, neto	7	923,593	1,136,034
Totali i aktiveve afatgjata		923,593	1,136,034
TOTALI I AKTIVEVE		10,714,164	12,492,442
 <u>DETYRIMET</u>			
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Llogari të pagueshme	8	3,015,125	2,927,346
Fatura të pambërritura	8	-	17,600
Totali i detyrimeve afatshkurtra		3,015,125	2,944,946
Aktivitet Neto	9	7,699,039	9,547,496
TOTALI I DETYRIMEVE		10,714,164	12,492,442

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<u>TË ARDHURAT</u>			
Kuotat e anëtarësisë për raste emergjente	10	34,264,000	-
Kuotat e anëtarësisë	10	27,033,500	20,164,000
Donacione dhe kontribute vullnetare	10	5,933,825	3,757,355
Të ardhura të tjera	10	3,762,009	5,886,609
Totali i të Ardhurave		70,993,333	29,807,964
<u>SHPENZIMET</u>			
Amortizimi	7	(247,443)	(289,557)
Shpenzime organizimi	11	(13,503,627)	(14,966,667)
Shpenzime promovimi dhe publikime	12	(6,409,210)	(3,897,246)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimi	13	(18,186,067)	(21,176,926)
Shpenzime të anëtarësisë për raste emergjente	13	(34,396,000)	-
Humbjet nga kursi i këmbimit		(99,444)	(149,616)
Totali i Shpenzimeve		(72,841,791)	(40,480,013)
Teprica e të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		(1,848,458)	(10,672,049)
Aktivet Neto në fillim të vitit		9,547,497	20,219,546
Aktivet Neto në fund të vitit		7,699,039	9,547,497

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Pasqyra e Flukseve Monetare

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>		
Teprica/Deficiti i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve	(1,848,458)	(10,672,049)
Rregullime për:		
Amortizim	7 247,443	289,557
Llogari të arkëtueshme	5 314,971	(1,605,745)
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	6 -	85,343
Pagesa për llogaritë e pagueshme	8 70,190	2,280,978
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit	(1,215,865)	(9,621,916)
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	7 (35,000)	(493,886)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	(35,000)	(493,886)
RRITJA NETO E MJETEVE MONETARE	(1,250,865)	(10,115,801)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4 8,325,877	18,441,678
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4 7,075,012	8,325,877

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar më 31.03.2020 dhe nënshkruar nga:

Spiro BRUMBULLI


Sekretar i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave

PwC Audit Shpk

Hartuesi

Spiro Brumbulli



Adriana Telkici



Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përqipet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 12 anëtarë, mbi baza vullnetare: Banka Alpha Albania sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Credins sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka e Tiranës sh.a. dhe Banka Union sh.a.

ABB ka pasur 6 punonjës me 31 Dhjetor 2019 (2018:6)

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lekë (Lekë), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

I. Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

II. Transaksionet në monedhë të huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un. Të gjitha kontributet dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve janë në Lekë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

Kursi i këmbimit më

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
LEKË/EUR	121.77	123.42

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël (vazhdim)

III. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

IV. Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksave vendore.

4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari rrjedhëse në Lekë	6,737,272	6,992,962
Llogari rrjedhëse në Euro	282,748	1,302,003
Para në arkë	54,992	30,912
Gjithsej	7,075,012	8,325,877

5. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime nga anëtarët	2,435,400	2,750,371
Gjithsej	2,435,400	2,750,371

6. Shpenzime të parapaguara

Shpenzime të parapaguar përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Garanci qira	280,160	280,160
Gjithsej	280,160	280,160

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

7. Aktivet e Qëndrueshme

Aktivitet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2018	2,025,691	1,959,306	3,984,997
Shtesat gjatë vitit 2019	35,000	-	35,000
Pakësimi gjatë vitit 2019	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2019	2,060,691	1,959,306	4,019,997
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2018	1,645,376	1,203,586	2,848,962
Amortizimi gjatë vitit 2019	58,468	188,974	247,443
Pakësimi gjatë vitit 2019	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2019	1,703,844	1,392,560	3,096,404
Vlera Neto			
Në 31 Dhjetor 2018	380,315	755,720	1,136,035
Në 31 Dhjetor 2019	356,847	566,746	923,593

8. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë	2,435,400	2,336,914
Kontributet e Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	216,949	204,704
Tatimi mbi te ardhurat personale	362,776	380,590
Tatim në Burim	-	5,138
Fatura të pambërritura	-	17,600
Gjithsej	3,015,125	2,944,946

9. Aktivet Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të AAB në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivet neto, paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar. Aktivet neto përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e ABB.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Në fillim të periudhës	9,547,496	20,219,546
Rritje/(Ulje) në aktivet neto	(1,848,458)	(10,672,049)
Vlera e mbartur në vitin e ardhshëm	7,699,039	9,547,497

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

10. Të ardhurat

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Kuota shtesë për raste emergjente	34,264,000	-
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	27,033,500	20,164,000
Sponsorizime nga bankat	5,933,825	3,757,355
Trajnime për bankat anëtare	3,762,009	5,886,609
Gjithsej	70,993,333	29,807,964

Kuotat shtesë për raste emergjente lidhen me rastet e tërmeteve të 1 Qershorit, 21 Shtatorit 2019 dhe 26 Nëntorit 2019, që goditën vendin. Me vendim të anëtarëve të shoqatës me 10 korrik 2019 u vendos te kontribuohen 10,000,000 leke Prefekturës së Korçës për rastin e tërmetit të 1 Qershorit 2019. Gjithashtu me 15 Dhjetor 2019, u vendos që te kontribuohen 200,000 Euro nga anëtarët e Shoqatës të Bankave me destinacion për raste emergjente nga tërmetet e 21 Shtatorit 2019 dhe 26 Nëntorit 2019, që goditën vendin. Kuota në shumën 10,000,000 lekë janë dhuruar me date 13 Shtator 2019 Prefekturës së Korçës për rastin e tërmetit të 1 Qershorit, dhe kuota në shumën 24,396,000 lekë janë dhuruar me date 27 Dhjetor 2019 Qeverisë Shqiptare për rastin e tërmetit të 21 Shtatorit dhe 26 Nëntorit.

11. Shpenzime Organizimi

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Trajnime për bankat anëtare	6,688,638	8,186,183
Evente dhe Tryeza pune	5,398,944	5,285,413
Anëtarësime	1,057,600	706,040
Udhëtime	358,455	789,031
Gjithsej	13,503,627	14,966,667

12. Shpenzime promovimi dhe publikime

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Publikime	3,364,027	3,722,704
Materiale informative dhe publicitet	3,045,184	174,542
Gjithsej	6,409,210	3,897,246

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEKË)

13. Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Shpenzime të anëtarësisë për raste emergjente (shënim 10)	34,396,000	-
Paga personeli	11,272,229	11,709,443
Qira	2,956,500	3,070,900
Kontribute për sigurime	1,164,004	1,315,385
Shpenzime komunikimi	1,150,483	1,091,136
Shpenzime konsulence	462,990	2,528,790
Shpenzime të tjera	343,707	304,033
Kancelari & të tjera të konsumueshme	338,600	572,317
Sigurim shëndeti	182,565	275,093
Shpenzime utilitare	161,887	148,714
Shërbime përkthimi	68,589	75,089
Komisione bankare	43,012	34,766
Abonime	17,500	13,500
Taksa lokale	15,000	15,000
Noterizime	9,000	22,760
Gjithsej	52,582,067	21,176,926



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE